



A.nr.498/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari-dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Argjenda Sherifi- në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.498/2026, të datës 05.05.2026, të parashtruar nga ankuesja Sh.G-H, nga Ferizaji, kundër Vendimit të datës 28.04.2026 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, më datë 15.06.2026

mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.498/2026, e datës 05.05.2026 e parashtruar nga ankuesja Sh.G-H.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil Sh.G-H, *(në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja)*, me datë 05.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.498/2026, kundër Vendimit me numër prot:01-111/01-19577 të datës 28.04.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *(në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli)* bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 12.05.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.05.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e parakohshme *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Lipjanit, më datë 13.03.2026, ka shpallë konkursin me numër reference: RN00019443, Grupi i Administrimit të përgjithshëm-Arsim i Lartë, pozita e punës *Zyrtar për Bibliotekë*, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.03.2026 deri më 12.04.2026.

Tutje, nga provat material të kësaj çështje rezulton se ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs mirëpo më Vendimin me numër prot:01-111/01-19577 të datës 28.04, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se: ... *nuk plotëson kriteret e përgjithshme të konkursit, respektivisht sipas pikës 3, lidhur me përvojën e punese: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punë si dhe pika 5 kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetimi/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë e cila nuk është mbështetur me dokumente përkatëse sipas kërkesave në konkurs.*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se i është refuzuar aplikacioni në mënyrë të kundërligjshëm. Shton se posedon përvojë disa vjeçare në fushën administrative dhe shërbimit me klientë dhe ka dorëzuar CV me specifik te angazhimit profesional. Kërkon që Këshilli ta rishqyrtoj vendimin për refuzim të aplikimit, mundësinë për plotësimin të dokumentacionit shtesë për dëshminë e përvojës se punës si dhe përfshirje në procesin e mëtejshëm të rekrutimit nëse konstatohet që i plotëson kriteret.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: “12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenit 17 të Rregullores 07/2025 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 05.05.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidatja për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtrtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së caktuar të rekrutimit, ndërsa, ankuesja në rastin konkret ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 05.05.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimin sipas konkursit me Nr. Ref: RN00019443, fakt ky i konfirmuara edhe përmes përgjigjes në ankesë të datës 14.5.2026, të Komunës së Lipjanit, rrjedhë se ankesa e ankueses A.nr.498/2026, e datës 05.05.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.498/2026 nuk mohon të drejtën e ankueses që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse. Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.498/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses Sh.G-H;*
- *Komunës së Lipjanit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*